

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE, SHOQËRISË “TRINISOFT” SHPK TIRANË

Për ushtrimin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2019

TË PËRGJITHËSHME DHE POLITIKAT KONTABEL

Shoqëria “TRINISOFT” SHPK, u regjistrua si biznes në datë 12/03/2009 me administrator Z. Artjon Aliko, me objekt veprimtarie: Projektim, modelim, prodhim, implementim dhe testim software. Kjo shoqëri është regjistruar pranë organeve tatimore me NIPTK91512006G.

MBI POLITIKAT KRYESORE TË KONTABILITETIT

Pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2019 janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 9901 të datës 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe të ligjit 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin e pasqyrat financiare”

Kontabiliteti ishoqërisë” TRINISOFT” SHPK, është i organizuar rregullisht, i mbështetur mbi sistemin manual të mbajtjes të kontabilitetit, si dhe ata të informatizuar të cilat mundësojnë jo vetëm regjistrimin e të dhënave por dhe marrjen e informacionit, respekton të gjitha kërkesat e Planit Kontabël, ligjin mbi Kontabilitetin dhe kërkesat e tjera ligjore. Llogaritë e ushtrimit financiar të vitit 2019 janë hartuar me hipotezën e vijueshmërisë dhe janë zbatuar vlerësimet e parashikuara në këtë situatë.

Monedha në të cilën shprehen të gjitha pasqyrat financiare është leku shqiptar pa bërë rumbullakime.

VLERËSIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Efikasiteti i kontrollit të brendshëm është i lidhur me sigurimin e mbrojtjes së pasurisë nga cdo lloj dëmtimi e shpërdorimi dhe në të njëjtën kohë të sigurojë besnikërinë e informacionit administrativ, kontabël e financiar duke qenë besueshëm nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga ndarja e punës, verifikimet dhe deri tek informimet, veprime këto që përgjithësisht në Entitet janë realizuar.


SHËNIME MBI ZËRAT E LLOGARIVE NË PASQYRAT FINANCIARE

AKTIVI AKTIVET MONETARE

Në këtë pozicion të bilancit janë pasqyruar, aktivet monetare në vlerën **10,448,873 lekë**, përcaktuar në llogaritë në arkë dhe në bankë. Ka vijueshmëri në regjistrimin e dokumentave, për sa i takon datave dhe ka dokumenta justifikuese për veprimet e kryera. Diferenca e likuiditeteve për vlerën **(9,243,755) lekë**, e pasqyruar drejt në pasqyrën e fluksit monetar bashkangjitur bilancit, përputhet me pasqyrimin e tyre në aktiv të bilancit.



1



| | |
|---------------------------------------|-------------------------|
| Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2018 | 19,692,628 lekë |
| Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2019 | 10,448,873 lekë |
| Diferenca | (9,243,755) lekë |

AKTIVE TË TJERA FINANCIARE AFATSHKURTËRA

Kërkesa të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit në vlerën 5,390,997 lekë ku përfshihet llogaria 411 "Kliente për mallra, produkte e shërbime". Kërkesa të arkëtueshme të tjera në vlerën 824,964 leke ku përfshihet llogaria 444 "Tatim mbi fitimin".

AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktive të tjera afatgjata materiale me vlerë kontabël për vlerën 899,319 lekë, ku përfshihen : llogaria 2182 "Pajisje informative" 813,433 leke, llogaria 2818 "Për të tjera AA materiale" 741,614 leke, llogaria 2181 "Mobilje dhe pajisje zyre" 827,500 leke.

PASIVI

HUATË E PARAPAGIMEVE

Për vitin ushtrimor 2019 detyrimet në total janë në vlerën **18,442,078 lekë** që në mënyrë analitike janë si më poshtë :

Detyrimet afatshkurtra me vlerë totale 18,442,078 lekë, ku përfshihen:


Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 439,352 lekë, ku përfshihet: llogaria 421 "Paga dhe shpërblime" 262,126 lekë dhe llogaria 431 "Sigurime shoqërore dhe shëndetësore" 177,225 lekë.

Të pagueshme për detyrimet tatimore në vlerën 91,700 lekë, ku përfshihet llogaria 442 "Tatim mbi të ardhurat personale" 225,300 leke.

Te tjera në vlerën 17,911,027 leke ku përfshihet llogaria 455 "Te drejta dhe detyrime ndaj ortakeve dhe aksionereve", llogaria 4457 "Shteti-TVSH e pagueshme".

KAPITALI

Gjendja e llogarive të Kapitalit dhe Rezervave të Shoqërisë në përfundim të periudhës është në vlerën **(877,924) leke** dhe përbëhet nga Kapitali i nënshkruar për **100,000 lekë**, nga Fitimi i Pashpërndarë **8,409,609 lekë** dhe Fitimi i vitit ushtrimor 2019, marrë nga PASH, me vlerë **(9,387,533) lekë**

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin 2019 Shoqëria "TRINISSOFT" SHPK ka realizuar shpenzime në masën **14,766,968 lekë** nga veprimtaria e shfrytëzimit. Shpenzimet janë si më poshtë:

Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit (3,884,063) lekë ku përfshihen: llogaria 604 "Bl.energji, avull,uje" në vlerën 293,289 lekë, llogaria 611 "Trajtime te pergjithshme" 701,184 lekë; llog 613 "Qira" 2,511,342 lekë, llogaria 618 "Të tjera" 10,480 lekë; llog 634 "Taksa dhe tarifa vendore" 101,000 lekë , llogaria 626 "Shpz. postare e telekom." 266,768 leke.

Paga në vlerën 9,599,615 lekë ku përfshihet 641 "Pagat dhe shpërblimet e personelit"

Shpenzimet e sigurimeve shoqërore për 1,142,371 lekë ku përfshihet llog 644 " Sigurimet shoqerore dhe shendetësore".

Shpenzimet financiare përfshijnë:

Llogaria 628 "Sherbime bankare" 60,093 lekë, llogaria 669 "Humbje nga kembimet valutore" 80,826 leke.

MBI TË ARDHURAT

Shoqëria ka realizuar të ardhura në masën **5,379,436 leke** nga veprimtaria e shfrytëzimit ku përfshihet:

Llogaria 704 " Shitje e punimeve dhe e sherbimeve" ne vleren 5,379,436 leke

PËRLLOGARITJA E TATIM FITIMIT

| | |
|----------------------------|-------------|
| FITIM/(HUMBJA) E USHTRIMIT | (9,387,533) |
| SHPENZIME TE PANJOHURA | |
| TATIM FITIMI (15%). | |
| FITIM/(HUMBJA) TATIMORE | (9,387,533) |

PASQYRA E FLUKSIT TË PARAVE-Metoda Indirekte

Eshtë ndërtuar nga ana e jonë në përputhje me standartet kombëtare të kontabilitetit, bazuar në levizjet e mjeteve monetare të shoqërisë sipas kërkesave që ka vetë pasqyra dhe në perfundim rezulton:

Mjete monetare në fillim **19,692,628 lekë**

Mjete monetare ne fund te periudhes **10,448,874 lekë**

Rritja/rrenja neto e mjeteve monetare **(9,243,755) lekë**

Pra,ka perputhje te plote te pasqyres te fluksit monetar dhe gjendjes te aktiveve monetare te vendosura ne aktiv te bilancit.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Eshtë plotësuar sipas kërkesave duke patur parasysh të gjitha ndryshimet e bëra midis dy periudhave ushtrimore dhe ku gjëndja e këtyre kapitaleve të vet shoqërisë në fund të periudhës paraqitet në vlerë prej



(877,924) lekë cila paraqitet si në pasqyrën e ndryshimit të kapitaleve, po ashtu edhe në postin e kapitaleve në pasiv të bilancit 2019.

SHËNIME TË TJERA SHPJEGUESE

Ngjarje të tjera të ndodhura pas datës të bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës të bilancit që nuk bëhen rregullime, nuk ka.

Duke patur parasysh shënimet e mësipërme, paraqitim të gjitha aspektet, të gjendjes financiare të shoqërisë deri më 31.12.2019.

Tiranë , më 24.03.2020

Ekonomisti

Bendis Husi



Administratori

Artjon Aliko

